




# AKK

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është themeluar në Kuvendin themelues me **30 qershor 2001**, pas zgjedhjeve të para demokratike komunale në Kosovën e pasluftës. Anëtarë të Asociacionit janë Komunitetet e Kosovës. Themelimi i AKK-së është mbështetur në **nenin 10 të Kartës Evropiane të Autonomisë Lokale në kuadër të Këshillit të Evropës** (e drejta për asociacion). AKK-ja sheh nevojën për të qartësuar kompetencat në fusha të ndryshme dhe të forcoj marrëdhëniet mes nivelit lokal dhe atij qendror.

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës dhe është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore).

[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

## Buletini

Viti II, Nr. 11

Korrik & Gusht 2005

### Përmbajtja e re e Buletinit të AKK-së

**Buletini** i Asociacionit të Komunave të Kosovës ka nisur të publikohet në muajin janar të viti 2004. Deri më tani përmbajtja e Buletinit të AKK-së ka përfshirë vetëm aktivitetet, projekte e raporte nga fushë-veprimtaria e AKK-së. Duke e parë rëndësinë e tij dhe në funksion të sqarimit të shumë çështjeve për pushtetin lokal të Kosovës, përmbajtja e tij do të pësoj ndryshime përmbajtjeore. Kështu nga ky numër, përveç publikimit të aktiviteteve të AKK-së dhe të kryetarëve e kryeshefave ekzekutiv të Komunave tashmë përmbajtja e Buletinit do të përmbaj edhe Intervista me kryetarë e kryeshefa ekzekutiv për probleme për çështje të ndryshme nëpër komuna, tema e artikuj për pushtetin lokal në përgjithësi si dhe trajtim të problemeve e sfidave mujore të çështjeve komunale. Duke shpresuar se niveli i bashkëpunimit mes përfaqësuesve komunal dhe ekipit që përgatit Buletinin e AKK-së do të rritet edhe më shumë, Ju ftojmë që për çështjet të ndryshme, sugjerime apo edhe kritika të drejtoheni në AKK-së përmes emailave [info@komunat-ks.net](mailto:info@komunat-ks.net), [arsimosmani@komunat-ks.net](mailto:arsimosmani@komunat-ks.net) ose [arsimi73@yahoo.com](mailto:arsimi73@yahoo.com) apo në zyret e AKK-së në Prishtinë.

**Për Buletinin e AKK-së**  
**ARSIM OSMANI**  
Menaxher për Komunikim



**Nga vizita e kryetarëve të komunave të Kosovës në Shqipëri**  
Vizitë Kompanisë së grumbullimit, përpunimit dhe eksportimit të bimëve medicinale dhe eterovajore **"Filipi"** (faqe 2 gjerësisht)

### AKK dënon vrasjen e dy qytetarëve të Kosovës të nacionalitetit serbë dhe plagosjen e dy të tjerëve

"Asociacioni i Komunave të Kosovës në emër të Komunave të Kosovës shpreh keqardhje dhe dënon ashpër vrasjen e dy qytetarëve të Kosovës të nacionalitetit serbë dhe plagosjen e dy të tjerëve. Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkon nga SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut që të punojë për ndriçimin e këtij rasti, në mënyrë që kjo ngjarje të mos keqpërdoret politikisht. Komunitetet e Kosovës u bëjnë thirrje qytetarëve të Kosovës që të punojnë ngushtë me policinë për zbardhjen e këtij dhe arrestimin kryesve të kësaj veprë, ngase kjo është në interesin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj". Deklarata është nënshkruar nga Z. Ismet Beqiri u.d së kryetarit të AKK-së.

### Kryetari Beqiri i uron shërim Presidentit Rugova

Në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës kryetari z. Ismet Beqiri ka lëshuar një deklaratë në të cilën ndër të tjera thuhet: "I nderuari president Rugova në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës të dëshiroj shërim të shpejtë e të plotë dhe kthim sa më parë në Kosovë".

# Sqarimi i Rregullorës 2005/13 (mbi PRONËN KOMUNALE)

Komisioni për Pronë në kuadër të AKK-së ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut për të bërë sqarimin e Rregullores 2005/13. Kryetari i Komisionit për Pronë në AKK-së z.Muharrem Shabani, njëherit kryetar i komunës së Vushtrrisë kërkoi sqarime në lidhje me këtë rregullore. Kryetari Shabani tha se "është kërkuar që të bisedohet me shefin e zyrës ligjore UNMIK-ut për të bërë sqarimet e mundshme në lidhje me privatizimin e disa ndërmarjeve të cilat janë specifike për nga natyra dhe gjithashtu të bisedohet për çështjet e ndryshme ekonomike të cilat janë në kontekst me Komunitat e Kosovës por edhe të sqarohet për pronat shoqërore dhe ato komunale. Z.Alexander Borg Olivier - Zyrtar Ligjor i UNMIK-ut dhe znj.Christina Rueger nga UNMIK/OLA thanë se duke pasur parasysh që UNMIK-u nuk lejon shitjen e pronës shoqërore në Kosovë, është gjetur një rrugëzgjdhje në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, që kjo pronë të lëshohet me qira për një afat të gjatë ku në këtë rast është 99 vite. Z.Olivier sqaroi që kjo rregullore (në këtë rast 2005/13) është hartuar për të bërë një lehtësim për investitorët, si ata të huaj por gjithashtu edhe për ata të brendshmit, të cilët do të dëshironin që ta shfrytëzonin pronën për një afat të gjatë në këtë rast për 99 vite. Nga ky takim është propozuar që të kërkohet nga UNMIK-u që të shkurtohen procedurat e gjata të kthimit të përgjigjeve nga UNMIK-u, sepse u dha vërejtje se ekzistojnë procedura të stërzgjatura për kthimin e ndonjë përgjigje nga zyret e ndryshme të UNMIK-ut. Po ashtu është kërkuar që të jepet më detajisht neni 2 i rregullores 2005/13 mbi dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme shoqërore që administrohet nga komuna në Kosovë të bëhet më i qartë.

## Pjesëmarrësit e takimit:

**Alexander Borg Olivier** - Zyrtar Ligjor i UNMIK-ut  
**Christina Rueger** - UNMIK/OLA  
**Muharrem Shabani** - Kryetar i Komisionit për Prona në AKK dhe kryetar i KK-Vushtri  
**Gani Sylaj** - Kryetar i Komunës së Drenasit  
**Islam Thaqi** - Kryeshf Ekzekutiv në Komunën e Kamenicës  
**Sylejman Sopa** - Drejtor i Drejtorisë për Marrëdhënie me Publikun në KK-Suharekë  
**Shahin Belegu** - Shef i Shërbimit Pronësor-Juridik në KK-Pejë  
**Naim Xhigoli** - Mbiëkspert në Sektorin e Pronave në KK-Obiliq



NGA VIZITA NE LAC: Kompania e grumbullimit, përpunimit dhe eksportimit të bimëve medicinale dhe eterovajore "Filipi"

## Kryetarët e Komunave të Kosovës vizituan Shqipërinë

Kryetarët e komunave të Kosovës gjatë vizitës së tyre në Shqipëri nga 2 deri më 4 gusht patën një varg takimesh e aktiviteteesh. Në këtë vizitë e cila u organizua nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe Agjencia e Zhvillimit 100% Shqip kryetarëve të komunave të Kosovës morën pjesë në aktivitetin "Festa 100% Shqip" në kuadër të fushatës mbarëkombëtare "Faleminderit që blini prodhime shqiptare". Qëllimi i kësaj vizite ishte zgjedhur për sensibilizimin edhe të ndërgjegjes së konsumatorëve shqiptarë në blerjen e produkteve me bazë lokale, po ashtu edhe të produkteve shqiptare në përgjithësi, sepse kështu, blerja e këtyre produkteve do të kthehej në investime, në më shumë vende pune dhe më shumë mirëqenie për të gjitha familjet tona. Në ditën e parë të vizitës kryetarët e komunave të Kosovës patën një turne vizitash në tri Bashkitë më të mëdha të Qarkut, pastaj në Rreshen, ku u vizitua kantina e verës "Arbri". Në Laç u vizitua Kompania e grumbullimit, përpunimit dhe eksportimit të bimëve medicinale dhe eterovajore "Filipi" ku kjo ndërmarje kishte të punësuar 400 punëtorë, derisa në Lezhë përkatësisht në fshatin Zejmen, u vizitua vreshta ku punohet sa i përket prodhimit të perimeve po ashtu edhe të prodhimeve blegtorale. Kryetarët e Komunave të Kosovës morën pjesë dhe vizituan edhe ekspozitën e fotografisë "Gjurmë". Në kuadër të kësaj vizite kryetarët e

Komunave të Kosovës dhe kryetarët e Bashkive të Shqipërisë zhvilluan një ndeshje futboll. Kryetarët e Komunave të Kosovës dhe ata të Bashkive të Shqipërisë u pritën një takim të veçantë edhe nga Agjencisë së Zhvillimit 100% SHQIP - Banka e Idevë. Me 4 gusht delegacioni i AKK-së (kryetarët e komunave të Kosovës) i kryesuar nga u.d. i kryetarit të AKK-së z. Ismet Beqiri u pritën nga kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë z.Sali Berisha. Gjatë këtij takimi, z.Ismet Beqiri u.d. i kryetarit të AKK-së e njoftoi kryetarin Berisha me progresin e arritur në Kosovë, hapat që po bëhen në Kosovë në lidhje me përmbushjen e standardeve dhe reformimin e pushtetit lokal. Ndërsa kryetari i PDSH-së z.Sali Berisha tha se "unë ndjek me vëmendje të njëjtë dhe të pandryshueshme të gjitha zhvillimet atje dhe kam kënaqësi të madhe për zhvillime realiste pozitive. Arteria Durrës- Prishtinë, por edhe më tej do të jetë një përparësi kryesore e qeverisë së ardhshme", - tha ai. Gjatë takimit u diskutua edhe për mundësinë e intensifikimit të lidhjeve ajrore, bashkëpunimin në fushën e turizmit, shoqëruar me fushat ekonomike dhe kulturore.

Vlen të ceket se një vizitë e tillë dhe takimet e kryetarëve të komunave të Kosovës dhe të Bashkive të Shqipërisë me sipërmarrësit privat lokal si dhe promovimi i produkteve mbarëkombëtare është planifikuar të mbahet në fillim të vitit të ardhshëm në Kosovë.



Kryetarët e Komunave të Kosovës gjatë takimit me udhëheqjen e Partisë Demokratike të Shqipërisë.

NGA PIESËMARRJA E PËRFAQËSUESIT TË AKK-së NË GRUPIN PUNUESE PËR LEGJISLACION TË QEVERISË SË KOSOVËS

## Sugjerohet që Ligji për Zgjedhjet Lokale të përfshij zgjedhjen e drejt-përdrejtë të kryetarëve të komunave

Grupi - Komisioni për Legjislacionin i Qeverisë së Kosovës deri më tani ka mbajtur tri mbledhje ku ky Grup Punues udhëhiqet nga z. Vedat Gashi zyrtar në Ministrinë e Pushtetit Lokal ndërsa AKK-në në këtë grup e ka përfaqësuar z. Muharrem Shabani anëtar i Këshillit të Kryetarëve të AKK-së dhe kryetar i Komunës së Vushtrrisë. Në këtë grup punues është përgatitur propozim-projekt Drafti i Ligjit të ri mbi Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë dhe sipas Programit të Punës së Grupit Punues parashihet që ky Ligj të nxirret deri në fund të vitit 2005. Lidhur me këtë Draft të propozuar për shqyrtimin e tij dhe vërejtjet eventuale, komentet dhe propozimet është mbajtur edhe një mbledhje e Grupit - Komisionit për Legjislacionin pranë AKK-së. Në bazë të diskutimit nga kjo mbledhje Komisioni për Legjislacionin të AKK-së - për nxjerrjen e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës z. Muharrem Shabani anëtar i Këshillit të Kryetarëve AKK-së dhe kryetar i komunës së Vushtrrisë i ka dërguar komentet në Draft-Propozimin e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.



- MUHARREM SHABANI - anëtar i Këshillit të Kryetarëve të AKK-së dhe kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Kryetari Shabani me këtë rast tha se "konsideroj se Ligji i ri mbi Vetëqeverisjen Lokale duhet të bazohet në parimet e Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe në mënyrë të qarët të definoj përgjegjësit dhe kompetencat e Pushtetit Lokal duke tentuar që të eliminohen të gjitha pengesat që shprehen negativisht në funksionimin efikas të Pushtetit Lokal". **Gjatë punës së Komisionit Legjislativ është potencuar se në ndërkohë është e nevojshme edhe nxjerrja e Ligjit mbi zgjedhjet Lokale e që sipas shumë sugjerimeve ato duhet të jenë të drejtpërdrejta e në veçanti zgjedhja e kryetarëve të komunave duhet të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët si dhe Ligjit mbi financat lokale sepse nga përvojat e deritanishme komunat kanë pasur pengesa të shumta lidhur me këtë çështje pasi që financat, procedura e shfrytëzimit të mjeteve buxhetore janë tepër të komplikuar të centralizuara dhe vështirësojnë punën e komunave në këtë lëmi./**

## DEKLARATA PËR KOMUNAT

### Ministri

### Haziri:

### Shumica e komunave tashmë

### kanë implementuar prioritet e standardeve




"Në të gjitha komunat ka rezultate pozitive në reformimin e pushtetit lokal dhe implementimin e standardeve dhe shumica e komunave tashmë ka implementuar prioritet e standardeve dhe fokusimi i tyre është në procesin e kthimit dhe në rritjen e efikasitetit të punës në komuna", ka deklaruar në

takimin me kryeshefat ekzekutiv të komunave të Kosovës, ministri i Pushtetit Lokal z. Lutfi Haziri, në të cilin është diskutuar për implementimin e standardeve, vlerësimin e tyre, funksionimin e pushtetit lokal, rritjen e efikasitetit si edhe për procesin e reformimit të pushtetit lokal në Kosovë tani.

## lajmeSHKURT

### Fuqizimi i Drejtorive Komunale në Rajonin e Dukagjinit

**Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Organizata Joqeveritare "Ne Jemi me Ju" kanë organizuar me datën 28 korrik 2005 një punëtori me temën "Kompetencat e Gjykatave të rregullta dhe organeve administrative lidhur me kontestet pronëzore".** Kjo punëtori e cila është organizuar si pjesë e projektit "Fuqizimi i Drejtorive Komunale në Rajonin e Dukagjinit" është mbështetur nga SDC-zyra në Prishtinë. Qëllimi i projektit është që përmes trajnimeve dhe punëtorive profesionale me ekspertë të ndryshëm nga fusha e Urbanizmit, Kadastrës dhe Çështje Pronësore- Juridike të ndihmojë vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në Drejtorit gjegjëse në 10 komunat e shënuara më lartë. Duke marrë pjesë në këtë takim Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së tha se "ekspertiza profesionale, trajnimet, puna në grupe janë pjesë e një metodologjie bashkëkohore të qasjes ndaj problemit dhe jemi të bindur se projekti në këtë drejtim ka kontribuar fuqishëm në ngritjen e kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale në këto drejtori. Rezultatet e para tashmë po vërehen, është prodhuar manuali, është ndërtuar shumë çka nga infrastruktura ligjore e aplikueshme në Kosovë". /



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

## BULETINI

Viti II, Nr. 11 - Korrik & Gusht 2005

### Bordi Botues:

Sazan Ibrahimimi, Arsim Osmani,  
Mexhit Shaqiri, Fisnik Mula,  
Hasime Osmani, Maliq Gashi,  
Slavisa Vasiq dhe Dardan Buqani

Tel: 038/ 245-732; 245-734; 245-735.

Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

www.komunat-ks.net



Statusin e Vëzhguesit



Anëtar i përhershëm

# Komunat e Kosovës dhe web-faqet e tyre

Prishtina	www.prishtina-komuna.org
Prizreni	www.komuna-prizren.org
Mitrovica	www.mitrovica-komuna.org
Gjilani	www.kk-gjilan.org
Gjakova	www.gjakova-komuna.org
Shtimja	www.shtime-komuna.org
Vitia	www.kk-viti.org
Istogu	www.komuna-istog.org
Klina	www.komuna-kline.org
Vushtrria	www.komuna-vushtrri.org
Podujeva	www.podujeva-komuna.org
Kaçaniku	www.komuna-kacanik.org
Ferizaji	www.ferizaj-komuna.org
Peja	www.peja-komuna.org
Lipjani	www.lipjan-komuna.org
Dragashi	www.komuna-dragash.org

Në kuadër të komunikimit më të mirë me opinionin dhe në proces të ofrimit të një transparence më të madhe për punën e tyre, Kuvendet Komunale të Kosovës kanë ndërtuar / realizuar edhe web faqet e tyre në internet. Në këto web faqe të komunave të Kosovës, qytetarët e tyre dhe opinioni i gjerë mund të informohet me detajisht për struk-

turën udhëheqëse komunale, organizimin e komunave, strukturën e tyre, aktivitetet e projekte komunale si dhe informata të tjera që mund të hyjnë në funksion të interesimeve të qytetarëve dhe të tjerëve. Njëkohësisht edhe komunat tjera të Kosovës janë në proces të ndërtimit / realizimit të web-faqeve të tyre në internet.



Pamje e web-faqes së AKK-së  
[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

Fillimi
Partnerët
Komisionet
Çka bëjmë ne?
Publikimet
Kalendari
Kontakt
Linq

rrë se erdhët ne faqën e Asociacionit të Komunave të Kosovës 16 Gusht, 2

**s për aktivitetet e kryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, të Bordit, të Komisioneve, si dhe oraret e**

MENU

- [Historiku](#)
- [Dokumentet themelore](#)
- [Planet dhe objektivat](#)
- [Qëllimi i Asociacionit](#)
- [Aktiviteti ndërkombëtar](#)
- [Struktura organizative](#)

**[Kryetarët e Komunave të Kosovës takohen në Lezhë me kryetarët e komunave të Shqipërisë](#)**

*E Martë, 02 Gusht, 2005 - 02:02 AM*

Asociacioni i Komunave të Kosovës, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe Agjencia e Zhvillimit 100% Shqip organizojnë vizitën në Lezhë në takimet e përbashkëta (nga 2 deri 4 gusht 2005) mes kryetarëve të komunave të Kosovës dhe të Shqipërisë me titull "Festa 100% Shqip" në kuadër të fushatës mbarëkombëtare "Faleminderit që blini prodhime shqiptare".

[Lexo më shumë](#)

**adresa e re e zyreve**

**Asociacioni i Komunave të Kosovës**

**Rr."Rexhep Mala" nr.12 Prishtinë**

**Tel: 038 245-732;**  
038 245-734; 038 245-735.

**Fax: 038 245-733**

**E-mail:**  
**info@komunat-ks.net**

**(rruga e parë në të majtë nga Menza e Studentëve)**

